



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:046507
Datë: 12.02.2024
Numri i dokumentit: 05315180

C - III. – 19 – 0174

Paditësja – propozuesja e sigurimit:

Shoqëria Tregtare, "M", me seli në Mitrovicë, R."S", pa nr. Mitrovicë e me numër unik identifikues,, e përfaqësuar nga I Z, dregjtor menaxhues e të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve, "R L", me seli në Prishtinë.

Kundër:

E paditura - kundërshtarja e sigurimit:

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Lagjja, "Lakrishtë", Rr. "Dritan Hoxha" Prishtinë.

Objekti i kontestit : Propozimi për lëshimin e masës së sigurimit.

Për: Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK) për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me Kolegjin në përbërje nga Agron J. Hoxhaj, gjykatës kryesues, Asllan Krasniqi, gjykatës dhe Bajram Miftari, gjykatës dhe antarë të kolegjit, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me dt.12.02.2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET si i bazuar propozimi i paditëses – propozueses së sigurimit, Shoqëria Tregtare, "M", L.C.C me seli në Mitrovicë për caktimin e masës së sigurimit e me të cilin, ka kërkuar që: "t'i urdhërohet kundërpropozueses, AKP-së, që të mos i tjetërsoj, shes, disponoj apo të ri lokoj sendet pa luajtshme, pronë e propozueses që përfshijnë : rezervoarin e izoluar me kapacitet 37000 L, me shtypje pune, 18.5 bar, Set avullues atmosferik me kolektor për oksigjen prej 100 Nm³/h – pesëmdhjetë pjesë të setit me konstrukcion mbajtës, kolektor kontrollues i gazit - stacion reduktues për oksigjen, me kapacitet 2 x 500 Nm³/h; Pajisje për kontrollimin e gazit – stacion matës për dorëzimin e oksigjenit të gazet dhe me ajër në flakëdhënësin e furrës; Shpërndarës/Injektor me

presion të oksigjenit; Pajisje për kontrollimin e gazit- softueri për operim automatik rreth furnizimit me ajër të flakëdhënësit të oksigjenit ; Instalime të pajisjeve përcjellëse të gazit; Gypa, FI 76.1 dhe F33.7; Pjesë lidhëse; bërryla; si dhe konstrukcione për vendosje të Rezervarit, të cilat janë në posedim të kundërshtarës së sigurimit respektivisht që këto Pajisje as të mos listohen si asete në procedurën e likuidimit të Ndërmarrjes, "Miniera dhe Industria e Magnezit, "G", Sh.P.K, gjithashtu edhe të mos ndërmarr asnjë veprim me të cilin këto asete të tjetërsohen, rilokohen dhe çfarëdo veprimi që mund t'i dëmtoj ato deri marrjen e një vendimi meritator në kontestin zhvillohet pranë kësaj gjykate"

II. Nuk caktohen taksa tjera gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Paditësi me dt.31.12.2019, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (tani e tutje, Dhoma e Posaçme) kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, përmes dërgimit me postë, ka paraqitur padinë për shkak të njohjes së pronësisë dhe dorëzimit në posedim të pajisjeve e me propozimin që të aprovohet në tërësi padia dhe kërkespadija e paditëses, të vërtetohet se pronar i pajisjeve : rezervoari me kapacitet 37000 L, avullues, mbajtës avullues, gazë shpërndarësi i oksigjenit, kolektor për gjendje të gazit, stacion reduktues, matës për rregullimin e gazit, pjesë përcjellës si gypa, lidhëse, bërryla të cilat janë të vendosura në hapësirat e kompanisë, Minierë dhe Industri e Magnezit, "Golesh" Sh.p.k., Lipjan, Magurë, nr.Bizneit 81035652, është, "M", L.C.C nr. fiskal 600029004 me seli në Mitrovicë, dhe detyrohet e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit që paditëses, t'ia pranoj të drejtën e pronësisë në pajisje dhe t'ia dorëzoj në posedim dhe t'ia lejoj tërheqjen e tyre, nga lokacioni ku janë të vendosura në kompaninë, Minierë dhe Industri e Magnezit (MIM), "Golesh" si dhe që t'ia kompensoj shpenzimet procedurale e më gjerësisht si në këtë padi.

Paditësja, kësaj padie, ia ka bashkangjitur provat gjegjëse :

- Kopjen e Certifikatës së dt.14.11.2006 së regjistrimit të paditëses, 'M, me seli në Rr."Sitnica" në Mitrovicë në ARBK e me nr.unik identifikues 810356552 dhe informatet për këtë Kompani;
- Kopjen e numrit fiskal 600029004 të paditëses, 'M", në Mitrovicë;
- Kopjen e ID-së së I Zt, drejtor menaxhues i paditëses, 'M, me seli në Mitrovicë;
- Kopjen e Faturës së dt.23 – 05.2014 për pagesën e kryer në shumën prej 5,300.00 euro;
- Kopja e shkresë së dt.23.05.2014 për shtyrjen e afatit;
- Kopja e Kontratës, Nr... e dt... e lidhur në mes të Minierës dhe Indistrisë së Magnezit, "Golesh", Sh.P.K dhe "M", L.C.C me seli në Mitrovicë;
- Kopja e Aneks dokumentit të Vërejtjes, Nr.001/2012 e lidhur në mes të Minierës dhe Indistrisë së Magnezit, "Golesh", Sh.P.K dhe "M", me seli në Mitrovicë;
- Kopja e shkresës së "M", me seli në Mitrovicë për Regjistrimin e Mjeteve Themelor/14.01.2016;

- Kopja e Vërejtjes, Nr.001/2014 rreth marrëveshjes (kontratës) për furizim me Gaz oksigjen i lëngët ndërmjet, Minierës dhe Indistrisë së Magnezit, "Golesh", Sh.P.K dhe "M", me seli në Mitrovicë;
- Kopja e regjistrimit të mjeteve themelore i dt.14.01.2016 të "M", me seli në Mitrovicë;
- Kopja e kërkesës së "M", me seli në Mitrovicë e dt.27.12.2018 të dërguar në adresë të AKP-së me seli në Prishtinë;
- Kopja e kërkesës, nr.001/2016 e dt.13.01.2016 e drejtorit menaxhues të "M", me seli në Mitrovicë;
- Kopja e Përgjigjes së Sh II , menaxher i përgjithshëm i MIM, "Golesh" në kërkesën e "M", me seli në Mitrovicë e dt.27.12.2018 të dërguar në adresë të AKP-së me seli në Prishtinë;
- Kopjet e komunikimeve përmes e maileve në mes palëve ndërgjyqëse;
- Kopja e fotografive të pajisjeve gjegjëse ;
- Kopjen e Njoftimit të AKP-s për të gjithë kreditorët dhe pronarët e ndërmarrjes për paraqitjen e dëshmive të kërkesë dhe interesit ndaj Minierës dhe Indistrisë së Magnezit, "Golesh", Nagurë, Fi680/89, dhe
- Kopja e shkresës së ARBK-së për të dhënat e paditëses – propozueses së sigurimit, "M", L.C.C me seli në Mitrovicë.

Me dt.21.12.2023, paditësja - propozuesja e sigurimit, i është drejtuar kësaj gjykate, me parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë së saj e me të cilën ka kërkuar që të aprovet në tërësi si e bazuar faktikisht dhe juridikisht kërkespadia e paditëses, "M", , të vërtetohet pronësia e paditëses mbi pajisjet të cilat i posedon Ndërmarrja MIM, Golesh dhe që përfshijnë : Rezervoari i izoluar me kapacitet 37000 L, me shtypjes pune 18.5 bar; Set avullues atmosferik me kolektor për oksigjen prej 100Nm³/h - pesëdhjetë pjesë të setit me konstrukcion mbajtës, Kolektor kontrollues i gazit – stacion reduketues për oksigjen, me kapacitet 2 X 500 Nm³/h; Pajisje për kontrollimin e gazit – stacion matës për dozimin e oksigjenit të gazët dhe furnizimin me ajër të flakëdhënësin e furrës, Shpërndarës/ Injektri me presion i oksigjenit; Pajisje për kontrollimin e gazit – softueri për operim automatik rreth furnizimit, me ajër të flakëdhënësit të Oksugjenit; Instalime të pajisjeve përcjellëse të gazit; gypa FI 76.1, FI 37.7; Pjesë lidhëse; bërryla; si dhe konstrukcione për vendosje të Rezervoarit, dhe të detyrohet e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit, të paguaj dëmin material në emër të zvogëlimit të pasurisë në shumën prej EUR 204.500.00 si dhe kamatën ligjore deri në pagesën e plotë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, të detyrohet e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit, të paguaj dëmin material në emër të fitimit të humbur për shkak të mos – përmbushjes së kontratës dhe atë në shumën vjetore prej EUR 740.000,00 që nga viti 2014 e deri në vlefshmërinë e kontratës, Nr..., së bashku me kamatën ligjore deri në pagesën e plotë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, detyrohet e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit, të paguaj dëmin material në emër të fitimit të humbur për shkak të pamundësisë së shfrytëzimit të pajisjeve, pronës e paditëses, në shumën e përcaktuar sipas ekspertizës financiare dhe atë së bashku me kamatën ligjore deri në pagesën e plotë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, si dhe të detyrohet e paditura, Agjencia Kosovare e

Privatizimit, të kompensoj, shpenzimet e përfaqësimit për paditësin, sipas tarifave të OAK-së e më gjerësisht si në këtë precizim të kërkesëpadisë.

Paditësja parashtrësës për precizimin e kërkesëpadiës, ia ka bashkangjitur provat :

- Kopjen e kërkesës së ‘M’ me seli në Mitrovicë e dt.27.12.2018 të dërguar në adresë të AKP-së me seli në Prishtinë dhe,

- Kopjen e Vërejtjes, Nr.001/2014 rreth marrëveshjes (kontratës) për furizim me Gaz oksigjen i lëngët ndërmjet, Minierës dhe Indistrisë së Magnezit, ‘Golesh’, Sh.P.K dhe ‘M’, me seli në Mitrovicë.

Me dt.19.12.2023, paditësja - propozuesja e sigurimit, përmes dërgimit me postë, i është drejtuar kësaj gjykate, edhe me propozimin për caktimin e masës së sigurisë e më të cilën ka kërkuar nga gjykata që të merr aktvendim, dhe të aprovohet si i themeltë propozimi i propozueses, dhe t’i urdhërohet kundërpropozueses, AKP-së që të mos i tjetërsoj, shes disponoj apo të ri llokoj sendet pa luajtshme, pronës e propozueses që përfshijnë : rezervoarin e izoluar me kapacitet 37000 L, me shtypje pune, 18.5 bar, Set avullues atmosferik me kolektor për oksigjen prej 100 Nm³/h – pesëmdhjetë pjesë të setit me konstrukcion mbajtës, kolektor kontrollues i gazit - stacion reduktues për oksigjen, me kapacitet 2 x 500 Nm³/h; Pajisje për kontrollimin e gazit – stacion matës për dorëzimin e oksigjenit të gazët dhe me ajër në flakëdhënësin e furrës; Shpërndarës/Injektor me presion të oksigjenit; Pajisje për kontrollimin e gazit- softueri për operim automatik rreth furnizimit me ajër të flakëdhënësit të oksigjenit ; Instalime të pajisjeve përcjellëse të gazit; Gypa, FI 76.1 dhe F33.7; Pjesë lidhëse; bërryla; si dhe konstrukcione për vendosje të Rezervarit, të cilat janë në posedim të kundërshtarës së sigurimit respektivisht këto pajisje as të mos listohen si asete në procedurën e likuidimit të Ndërmarrjes, Miniera dhe Industria e Magnezit, ‘Golesh’, Sh.P.K, gjithashtu edhe të mos ndërmarr asnjë veprim me të cilin këto asete të tjetërsohen, rilokohen dhe çfarëdo veprimi që mund t’i dëmtoj ato deri marrjen e një vendimi meritor në kontestin zhvillohet pranë kësaj gjykate.

Paditësja – propozuesja e sigurimit, ‘M’, me seli në Mitrovicë në padinë si dhe në propozimin e saj për caktimin e masës së sigurimit, ka vënë në pah rrjedhën e rastit dhe përmbledhjen e kërkesave të palëve dhe se në propozimin për caktimin e masës së sigurimit, në mes tjerash ka cekur argumentet juridike lidhur me këtë propozim dhe atë nga neni 61 .1 të Ligjit, Nr.06/L – 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ku për caktimin e masës së sigurimit, kërkohet plotësimi i dy kriterëve ligjore për caktimin e masës së sigurimit: a) ekzistimi i kërkesës apo të drejtës subjektive, dhe b) rreziku i shkaktimit të dëmit të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm në rast se nuk ndërrmerret, si dhe dispozitat e nenin 297, të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), se paditësja – propozuesja e sigurimit, argumenton se asnjëra nga palët nuk e ka kontestuar të drejtën e pronësisë së paditëses në pajisjet e të cilat e paditura përmes Ndërmarrjes i ka në posedim, dhe se përmes provave të bashkangjitura padisë dhe propozimit për masën e sigurimit, paditësja – propozuesja e sigurimit, e ka bërë të besueshme bazën e kërkesëpadisë, se mos caktimi eventual masës së sigurimit gjithashtu paraqet rrezik për arritshmërinë e kërkesëpadisë së paditëses për shkakun se Ndërmarrja e cila është nën administrimin e drejtëpërdretë nga e paditura – kundërpropozuesja ka hyrë në procedurën e likuidimit, dhe se e njëjta për këtë çështje ka humbur rastin në Tribunalin e Arbitrazhit (dëshmohet përmes Njoftimit për Likuidim të datës së bashkangjitur me këtë shkresë), se me humbjen e pajisjeve, paditësja – propozuesja, humb kapital prej EUR 300,000,00 por edhe për veç demit, paditësja – propozuesja pëson fitim të humbur, se dëmi i tillë, është pa ri parueshëm në kuptimin

e saj se në rast të tjetërsimit apo shitjes së pajisjeve, ajo si propozuese, do të ballafaqohet me vështirësi të blerjes së po të njëjtave, se mos caktimi i masës së sigurimit, paditësja – propozuesja e sigurimit, as nuk do të mund të kompensohet financiarisht nga Ndërmarrja pasi që vet fakti se e njëjta është në procedurën e likuidimit nënkupton se përmbushja e detyrimeve, është e limituar në kapitalin të cilin kjo ndërmarrje e posedon, dhe i cili nuk mund të jetë i mjaftueshëm për kompensim të tërë demit të shkaktuar ndaj propozuesit, këtu paditëses – propozueses së sigurimit.

Më tej paditësja - propozuesja e sigurimit në propozimin e saj për caktimin e masës së sigurimit, ka theksuar se sa i përket kushtit që masa e sigurisë të mos i shkaktoj dëm kundërpropozueses, këtu të paditurës – kundërshtares së sigurimit, propozuesja, këtu paditësja - propozuesja e sigurimit, argumenton për gjykatën dhe se ndërmarrja, nuk është funksionale dhe se pajisjet nuk janë përdorur asnjehere qoftë nga ndërmarrja qoftë nga kundërpropozuesja, këtu e paditura – kundërshtarja e sigurimit, prandaj objekti i caktimit të masës së sigurisë nuk do të shkaktonte asnjë dëm ndaj kundërpropozueses, këtu të paditurës – kundërshtares së sigurimit, si dhe se së dyti, propozuesja, këtu paditësja - propozuesja e sigurimit, argumenton për gjykatën se ndaj Kundërpropozueses, këtu të paditurës – kundërshtares së sigurimit, nuk mund të shkaktohet dëm për vet faktin se ai apo Ndërmarrja nuk kanë ndonjë të drejtë pronësie po posedimi mbi pajisjet, se argumentet e mës sipërme i shërbejnë gjykatës të konstatoj se, (i) propozuesja, e ka bërë të besueshme kërkesëpadinë e e saj, (ii), Dëmi i cili rrezikohet të shkatohet është i pariaprueshëm, dhe se (iii) me caktimin e masës së sigurisë, kundërpropozueses, këtu të paditurës – kundërshtares së sigurimit, nuk i shkatohet asnjë dëm, prandaj i ka propozuar gjykatës që të aprovohet si i themeltë propozimi i propozueses, dhe t'i urdhërohet kundërpropozueses, AKP-së që të mos i tjetërsoj, shes disponoj apo të ri llokoj sendet pa luajtshme, pronës e propozueses që përfshijnë : rezervoarin e izoluar me kapacitet 37000 L, me shtypje pune, 18.5 bar, Set avullues atmosferik me kolektor për oksigjen prej 100 Nm³/h – pesëdhjetë pjesë të setit me konstrukcion mbajtës, kolektor kontrollues i gazit - stacion reduktues për oksigjen, me kapacitet 2 x 500 Nm³/h; Pajisje për kontrollimin e gazit – stacion matës për dorëzimin e oksigjenit të gazët dhe me ajër në flakëdhënësin e furrës; Shpërndarës/Injektor me presion të oksigjenit; Pajisje për kontrollimin e gazit- softueri për operim automatik rreth furnizimit me ajër të flakëdhënësit të oksigjenit ; Instalime të pajisjeve përcjellëse të gazit; Gypa, FI 76.1 dhe F33.7; Pjesë lidhëse; bërryla; si dhe konstrukcione për vendosje të Rezervarit, të cilat janë në posedim të kundërshtarës së sigurimit respektivisht këto pajisje as të mos listohen si asete në procedurën e likuidimit të Ndërmarrjes, Miniera dhe Industria e Magnezit, "Golesh", Sh.P.K, gjithashtu edhe të mos ndërmarr asnjë veprim me të cilin këto asete të tjetërsohen, rilokohen dhe çfarëdo veprimi që mund t'i dëmtoj ato deri marrjen e një vendimi meritor në kontestin zhvillohet pranë kësaj gjykate.

Paditësja – propozuesja sigurimit, propozimit të saj për caktimin e masës së sigurimit, ia ka bashkangjitur provat gjegjëse :

- Kopja e Vërejtjes, Nr.001/2014 rreth marrëveshjes (kontratës) për furnizim me Gaz oksigjen i lëngët ndërmjet, Minierës dhe Industrisë së Magnezit, "Golesh", Sh.P.K dhe "M", me seli në Mitrovicë;
- Kopja e regjistrimit të mjeteve themelore i dt.14.01.2016 të "M", me seli në Mitrovicë;
- Kopja e kërkesës së "M", me seli në Mitrovicë e dt.27.12.2018 të dërguar në adresë të AKP-së me seli në Prishtinë;
- Kopja e Përgjigjes së Sh II , menaxher i përgjithshëm i MIM, "Golesh";

- Kopjet e komunikimeve përmes e maileve në mes palëve ndërgjyqëse;
- Kopja e fotografive të pajisjeve gjegjëse ;
- Kopjen e Njoftimit të AKP-s për të gjithë kreditorët dhe pronarët e ndërmarrjes për paraqitjen e dëshmime të kërkesës dhe interesit ndaj Minierës dhe Industrisë së Magnezit, "Golesh", Nagurë, Fi680/89, dhe
- Kopja e shkresës së ARBK-së për të dhënat e paditëses – propozueses së sigurimit, "M", me seli në Mitrovicë.

Me dt.27.12.2023, Dhoma e Posaçme, me Urdhrin e saj, C - III. – 23 – 0174 të dt.27.12.2023, të paditurës – propozuese së sigurimit, AKP-së, i ka dërguar padinë dhe kërkesën e paditësit për caktimin e masës së sigurimit dhe se e njëjta, me dt.03.01.2024, ka paraqitur përgjigje në propozimin e paditëses – propozueses së sigurimit për caktimin e masës së sigurimit e duke konsideruar se propozuesi nuk ka ofruar prova të besueshme nga të cilat argumentohen faktet e rëndësishme për t'iu falur besimi i plotë në aprovimin e këtij propozimi , se faktet e ngritura nga paditësi duke pretenduar se ka hyrë në një raport kontraktual si burim i të drejtave dhe detyrimeve, nuk mund të argumentohet se ato raporte kanë krijuar efekt dhe ndaj AKP-së pa qenë fare palë kontraktuese, se kontraktuesja, Miniera dhe Industria e Magnezit, "Golesh", Sh.p.k, Lipjan, Magurë, në cilësinë e blerëses së gazit industrial, në rend të parë nuk i ka përmbushur obligimet kontraktuese që i ka pasur me AKM-në përkatësisht me AKP-në, dhe meqenëse, këto Agjenci, nuk mund të trajtohen si agjenci e sigurimeve, ka konsideruar se edhe paditja nuk mund të kërkoj dëshpërblime të tilla, se me kohë kur paditësi ka kërkuar lirim të pajisjeve është njoftuar se për një kërkesë të tillë, duhet që t'i drejtohet Gjykatës kompetente - Dhomës së Posaçme sikur edhe disa nënkontraktues të tjerë po operator tjerë të kontraktuar për punë të ndryshme nga kjo Ndërmarrje, Miniera dhe Industria e Magnezit, "Golesh", Sh.p.k, Lipjan, Magurë, në cilësinë e blerëses së gazit industrial, se propozimi nuk përmabn arsyetim të mjaftueshëm dhe të bazuar në fakte të argumentuara, se nga mos aprovimi i masës së sigurisë, paditëses, do t'i shkatohet dëm i pa riparueshëm apo i pa kompensueshëm në mjete monetare dhe i atçastshëm, se sipas nenit 61 par.1 të Ligjit nr.06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK), parashihet se : *"Me kërkesën e palës, Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë altvendim për aprovimin e masës së sigurisë sëpërkohshme nëse pala jep prova të besueshme se dëmi, humbja apo dëmtimi janë të drejtë përdrejta dhe të riparueshme, si dhe të kenë pasojë për palën nëse nuk lëshohet aktvendimi për aprovimin e masës së sigurisë"*, se prova të besueshme për paraqitjen e dëmit, nuk mund të jenë nëse nuk prezentohen edhe provat nga të cilat vlerësohet se paditësi mund të fitoj të drejtën e tij të pretenduar, se paditësja që kërkon aprovimin e masës së sigurisë duhet që të dorëzoj dëshmi të besueshme me të cilat supozohet se mund që t'a bind gjykatën që me aktvendim t'a parandaloj, AKP-në, për shitjen e pajisjeve në pronës të paditëses, se sipas këtij propozimi, AKP-ja, paska mundësi shitjen e asteve në pronësi private, se nuk qëndron ky fakt ngase deri më tani ende nuk është shitur asnjë aset me dyshime të tilla dhe që nuk regjistrohej pronësi shoqërore e NSh-ve, se një dyshim i tillë është i tepërt ngase AKP-ja, as nuk planifikon ndonjë shitje të tillë, atëherë si mund të plotësohet kriteri bazik i shkaktimit të dëmit kur AKP-ja, në rend të parë, nuk ka qenë palë kontraktuese si dhe e njëjta nuk mund që t'i lë peng proceset e zbatimit të ligjit me të cilin është formuar si Agjenci e Pavarur për administrimin e Ndërmarrjeve Shoqërore dhe asetëve të tyre.

Tutje e paditura – kundërshtarja e sigurimit, ka theksuar se tani lind pyetja cila është arsyeja e aprovimit të masës ndaj AKP-së, e cila do të jetë pa kurrëfarë efekti, ngase kreteri numrë një për aprovimin e masës së sigurisë, "shkaktimi i dëmit", nuk plotësohet, e gjithashtu kurrëfarë e drejte nuk mund t'i dëmtohet paditëses për shkak të mos aprovimit apo caktimit të kësaj masës të sigurisë, se fakti se paditësi, nuk e ka bërë të besueshëm kërkesën për aprovimin e masës së sigurisë, është i pa mohueshëm, për këtë arsye, AKP-ja, këtu e paditura, - kundërshtarja e sigurimit, i propozon Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, që pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të kësaj lënde, si dhe vlerësimit të tyre, të merr aktvendim e me të cilin, refuzohet në tërësi si e bazuar propozimi i M, L.C.C me seli në Mitrovicë, me qëllim që t'i ndalohej, AKP-së, tjetërsimi, shitja, disponimi apo ri lokimi i sendeve të sendet pa luajtshme, në pronësi të propozueses të situar si pajisje me qëllim të furnizimit me gazë për Miniera dhe Industria e Magnezit, "Golesh", Sh.p.k, Lipjan, M, në cilësinë e blerëses së gazit industrial, si dhe të obligohet paditësja, që t'i paguaj shpenzimet procedurale që do të krijohen deri në fund të këtij kontesti e më gjerësisht si në Përgjigje në propozimin e paditëses – propozuese së sigurimit për caktimin e masës së sigurimit.

Me dt.11.01.2024, DhPGJSK-ja, me urdhrin e saj, C – III. – 19 – 0174 të dt.11.01.2024, Përgjigjen e të paditurës – kundërshtarës së sigurimit të dhënë në propozimin e paditëses - propozueses së sigurimit për caktimin e masës së sigurimit për caktimin e masës së sigurimit, ia ka dërguar të njëjtës.

Me dt.31.1.2024, paditësja- propozuesja e sigurimit, ka paraqitur Kundërpërgjigje në Përgjigjen e të paditurës, AKP-së të paraqitur në propozimin e paditëses – propozueses së sigurimit, e në të cilën në mes tjerash, ka deklaruar se sin ë padi por edhe në propozimin e saj e ka bërë të besueshme kërkesëpadinë e saj e konkretisht se asetet të cilat ka AKP-ja, i ka në posedim janë pronë e paditëses- propozuese së sigurimit dhe se me rastin e shitjes, bartjes, ri lokimit apo tjetërsimit të tyre, dëmi mund të jetë e pa riparueshëm, se në këtë Kundërpërgjigje ka cituar argumentet e saj të njëjta juridike siç i ka cekur në propozimin e saj për caktimin e masës së sigurimit pra, në nenin 61 të Ligjit për DhPGJSK-së për caktimin e masës së sigurimit e duke i propozuar gjykatës që të aprovohej propozimi i saj për caktimin e masës së sigurimit dhe se kësaj Kundërpërgjigje, ia ka bashkangjitur fotot e pajisjeve për të cilën e kërkon pronësinë dhe arsyen për caktimin e masës së sigurimit, si dhe njoftimin e AKP-së për të gjithë kreditorët dhe pronarët e Ndërmarrjes Shoqërore (NSh), Minieradhe Industria e Magnezit, "Golesh", me seli në Magurë e më gjerësisht si në këtë kundërpërgjigje.

Me dt.23.01.2024, DhPGJSK-ja, me urdhrin e saj, C – III. – 19 – 0174 të dt.23.01.2024, ka urdhëruar paditësen - propozuesen e sigurimit, që kësaj gjykate, t'ia siguroj vendimin e Tribunalit të Arbitrazhit dhe se me dt.31.01.2024, pala paditëse – propozuesja e sigurimit, i është përgjigjur urdhrin të kësaj gjykate dhe se dt.05.10.2023 së bashku me provën bashkangjitur (artikull i gazetës ditore), e në të cilën ka sqaruar për argumentin e propozueses së sigurimit se ish pronarët e Ndërmarrjes MIM, "Golesh" kanë humbur rastin në Tribunalin e Arbitrazhit është përdorur për të dëshmuar gjykatës se kjo ndërmarrja tani është nën administrimin e drejtë përdrejtë nga AKP-ja, se Vendimi i tillë nuk është i qastshëm për palët dhe gjykatën.

Për detaje të tjera referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor

Ne bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Procedura gjyqësore pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar Ligjin nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si ligj i veçantë.

Në bazë të nenit 61 par.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban propozimi për caktimin e masës së sigurimit, nuk e vërtetojnë propozimin për caktimin e masës së sigurimit dhe se gjykata merr aktvendim, pa caktuar seancën dëgjimore.

Pas shqyrtimit të propozimit të paditësit – propozuesit të sigurimit për caktimin e masës së sigurimit si dhe pretendimeve të të paditurës të dhëna në përgjigjen e saj në propozimin për caktimin e masës së sigurimit, gjykata ka vlerësuar dhe ardhur në përfundimin se propozimi i paditësit – propozuesit të sigurimit, për caktimin e masës së sigurimit, është i pabazuar.

Pas shqyrtimit të propozimit të paditësit – propozuesit të sigurimit, Shoqëria Tregtare, ‘M’, L.C.C me seli në Mitrovicë për caktimin e masës së sigurimit si dhe pretendimeve të të paditurës – kundërshtarës së sigurimit të dhëna në përgjigjen e saj të dhënë në propozimin për caktimin e masës së sigurimit, gjykata ka vlerësuar dhe ardhur në përfundimin se propozimi i paditëses – propozueses së sigurimit për caktimin e masës së sigurimit, **është i pabazuar**,

Në bazë të nenit 61 par.1 të Ligjit nr.06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), parashihet se : “... *Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kushte që parashtruesi jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive ti tij, dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të riparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i pa riparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar...*”. Në rastin konkret, paditësi – propozuesi i sigurimit, i ka propozuar gjykatës që të merr aktvendim, dhe të aprovohet si i themeltë propozimi i propozueses, dhe t’i urdhërohet kundërpropozueses, AKP-së që të mos i tjetërsoj, shes disponoj apo të ri lokoj sendet pa luajtshme, pronës e propozueses që përfshijnë : rezervoarin e izoluar me kapacitet 37000 L, me shtypje pune, 18.5 bar, Set avullues atmosferik me kolektor për oksigjen prej 100 Nm³/h – pesëmdhjetë pjesë të setit me konstrukcion mbajtës, kolektor kontrollues i gazit - stacion reduktues për oksigjen, me kapacitet 2 x 500 Nm³/h; Pajisje për kontrollimin e gazit – stacion matës për dorëzimin e oksigjenit të gazët dhe me ajër në flakëdhënësin e furrës; Shpërndarës/Injektor me presion të oksigjenit; Pajisje për kontrollimin e gazit- softueri për operim automatik rreth furnizimit me ajër të flakëdhënësit të oksigjenit ; Instalime të pajisjeve përcjellëse të gazit; Gypa, FI 76.1 dhe F33.7; Pjesë lidhëse; bërryla; si dhe konstrukcione për vendosje të Rezervarit, të cilat janë në posedim të kundërshtarës së sigurimit respektivisht këto pajisje as të mos listohen si asete në procedurën e likuidimit të Ndërmarrjes, Miniera dhe Industria e Magnezit, ”Golesh”, Sh.P.K, gjithashtu edhe të mos ndërmarr asnjë veprim me të cilin këto asete të tjetërsohen, rilokohen dhe çfarëdo veprimi që mund t’i dëmtoj ato deri marrjen e një vendimi meritor në kontestin zhvillohet pranë kësaj gjykate.

Mirëpo gjykata mund të nxjerr - lëshoj një masë të sigurisë me kusht që parashtruesi të jep prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pa riparueshme për palën gjegjëse nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i ”*pariparueshëm*” vetëm nëse nuk mund të

zhëdmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Padiësja – propozuesja e sigurimit, në propozimin e saj për caktimin e masës së sigurimit, precizimin e kërkesëpadiësë si dhe në propozimin për caktimin e maës së sigurisë, ka theksuar se pajisjet në fjalë të listuara si në padi janë në pronësi të saj dhe se ky fakt sipas tij përbën dëshmi të mjaftueshme se e ka bërë të besueshme kërkesëpadinë, se mos caktimi eventual masës së sigurimit gjithashtu paraqet rrezik për arritshmërinë e kërkesëpadiësë së paditëses për shkakun se Ndërmarrja e cila është nën administrimin e drejtë përdrjetë nga e paditura – kurdërpropozuesja ka hyrë në procedurën e likuidimit, dhe se e njëjta për këtë çështje ka humbur rastin në Tribunalin e Arbitrazhit (dëshmohet përmes Njoftimit për Likuidim të datës së bashkangjitur me këtë shkresë), se me humbjen e pajisjeve, padiësja – propozuesja, humb kapital prej EUR 300,000,00 por edhe për veç demit, padiësja – propozuesja pëson fitim të humbur, se dëmi i tillë, është pa ri parueshëm në kuptimin e saj se në rast të tjetërsimit apo shitjes së pajisjeve, ajo si propozuese, do të ballafaqohet me vështirësi të blerjes së po të njëjtave, se mos caktimi i masës së sigurimit, padiësja – propozuesja, as nuk do të mund të kompensohet financiarisht nga Ndërmarrja pasi që vet fakti se e njëjta është në procedurën e likuidimit nënkupton se përmbushja e detyrimeve është e limituar në kapitalin të cilin kjo ndërmarrje e posedon, i cili nuk mund të jetë i mjaftueshëm për kompensim të tërë demit të shkaktuar ndaj propozuesit, këtu paditëses – propozueses së sigurimit dhe se padiësja – propozuesja e sigurimit, pretendon se në këtë fazë të procedurës, janë plotësuar kushtet kumulative për caktimin e masës së sigurimit

E paditura – kundërshtarja e sigurimit, AKP, në Përgjigjn e dhënë, e ka kundërshtuar propozimin e paditëses - propozueses së sigurimit për lëshimin e masës së sigurimit, dhe ka shprehur qëndrimin se pretendimet e paditëses janë të pa bazuara e duke theksuar se padiësja që kërkon aprovimin e masës së sigurisë, duhet që të dorëzonte dëshmi të besueshme me të cilat supozohet se mund që t'a bind gjykatën që me aktvendim t'a parandaloj, AKP-në, për shitjen e pajisjeve në pronësi të paditëses, se sipas këtij propozimi, AKP-ja, paska mundësi shitjen e e asteve në pronësi private, se nuk qëndron ky fakt ngase deri më tani ende nuk është shitur asnjë aset me dyshime të tilla dhe që nuk regjistrohej pronësi shoqërore e NSh-ve, se një dyshim i tillë është i tepërt ngase AKP-ja, as nuk planifikon ndonjë shitje të tillë, atëherë si mund të plotësohet kriteri bazik i shkaktimit të demit kur AKP-ja, në rend të parë, nuk ka qenë palë kontraktuese si dhe e njëjta nuk mund që t'i lë peng proceset e zbatimit të ligjit me të cilin është formuar si Agjenci e Pavarur për administrimin e Ndërmarrjeve Shoqërore dhe asetëve të tyre. Mirëpo palët duhet të ofrojnë prova të besueshme se do të rezultojnë me dëmtim të menjëhershëm dhe të pa riparueshëm financiarisht nëse nuk miratohet kërkesa e tyre e këto kriteret janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga ato: se ka gjasa reale për t'a fituar rastin, se ai ballafaqohet me shkaktimin e demit të pa riparueshëm nëse nuk lëshohet masa e sigurimit etj, dhe nëse njëra nga këto kriteret mungojnë, kërkesa do të refuzohet. Barra e provave bie mbi paditësen – propozuesen e sigurimit, andaj pa paragjykim të vendosjes së plotë lidhur me çështjen kryesore të padisë së paditësit – njohja e të drejtës së pronësisë dhe dorëzimit në posedim të pajisjeve, gjykata konstaton se në këtë rast, padiësja– propozuesja e sigurimit, nuk ka ofruar dëshmi të besueshme, që do të arsyetonin lëshimin e masës së sigurimit sepse e njëjta, nuk ka parashtruar asnjë dëshmi mbi ekzistimin e rrezikut të demit dhe për më tepër të parashtror asnjë dëshmi e që do të argumentonte që dëmi i menjëhershëm (atëçastshëm) dhe i pa riparueshëm, asaj si palë, do t'i shkaktonte në qoftë se masa e sigurimit nuk do të lëshohej – caktonte e për më tepër, pasi që sendet janë në pronësi private, ato nuk mund të shiten nga e paditura, - kundërshtarja e sigurimit, AKP me seli në Prishtinë, dhe se as nuk ka planifikuar që të bëjë shitjen e tyre por edhe se e paditura, - kundërshtarja e sigurimit, AKP me seli në Prishtinë, nuk ka qenë edhe palë kontraktuese, andaj si rezultat i këtij qëndrimi del përfundimi se propozimi i paditëses – propozueses së sigurimit, AKP-së me seli në Prishtinë për caktimin e masës së sigurimit, nuk i

plotëson kriteret ligjore ashtu siç parashihen sipas nenit 61 par.1 të Ligjit për DhPGJSK-së dhe se për këtë arsye kjo gjykatë, propozimin e paditëses – propozuesit të sigurimit, Shoqëria Tregtare, “M”, me seli në Mitrovicë për caktimin e masës së sigurimit, e refuzoj si të pabazuar.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 4 par.9, 9 dhe nenit 61 par.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP).

Shpenzimet procedurale:

Paditësja – propozuesja sigurimit, ka paguar taksën gjyqësore për propozimin për caktimin e masës së sigurimit dhe atë në shumën prej 100.00 € (një qind) dhe se për këtë arsye, gjykata edhe nuk caktoj taksa tjera gjyqësore në këtë çështje juridike kontestimore.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS **2023:046507, 12.02.2024**

Kolegji i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës

Agron Hoxhaj, Gjykatës kryesues _____

Asllan Krasniqi, Gjykatës _____

Bajram Miftari, Gjykatës _____

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet Ankesa - Apeli me shkrim për Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (DhPGjSK) dhe atë në afat prej **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi dhe atë në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (DhPGjSK).